

Burimet: deklarata Sh.R, FDH-40622; J. Osmani, *Krimet...*, I, 302.

Ymer (Muhamet) Bytyqi

(14.03.1956, shqiptar nga Nishori/Nišor, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Arben (Avdyl) Ukshini

(15.02.1976, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Ahmet (Idriz) Pulatani

(1.05.1976, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Nezir (Halim) Elezaj

(1.03.1977, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Sylejman (Mustafë) Avdyli

(10.04.1978, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Blerim (Bajram) Ukshini

(24.04.1978, shqiptar nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Arbeni, Ahmeti, Neziri, Sylejmani dhe Blerimi aderuan në njësitin e UÇK-së në fshatin e vet [Morinë/Morina] dhe kjo menjëherë pas themelimit të këtij njësi, në muajin mars të vitit 1998. Ymeri me prejardhje ishte nga Nishori/Nišor, por mbi njëzet vjet ka punuar jashtë vendit. Pas fillimit të luftës në Kosovë, Ymeri u angazhua në mbledhjen e kontributeve për UÇK-në në Gjermani. Së shpejti edhe vet aderoi në UÇK. Në muajin qershor të vitit 1998, kaloi në Kosovë përmes rajonit të Morinës/Morina.

Arbeni, Ahmeti, Neziri, Sylejmani, Blerimi dhe Ymeri kanë rënë gjatë luftimeve me forcat serbe, që u zhvilluan më 7.07.1998 te **Morina**. Pjesëtarët e forcave serbe i kanë çuar trupat e tyre në Gjakovë/Đakovica, ndërkaq ndërmarrja komunale *Çabrat/Čabrat* e ka organizuar varrimin e tyre. Pas përfundimit të luftës, u krye zhvarrimi dhe identifikimi i mbetjeve të tyre mortore. Sot, ata prehen në varrezat e Gjakovës/Đakovica.

Burimet: deklarata H.E, FDH-31938; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; J. Martinsen,

Regjistri..., FDH-26092; fotografi, FDH-24984.

Emine (Mon) Ukshini-Time

(7.11.1914, shqiptare nga Morina, komuna e Gjakovës/Đakovica, amvise, katër fëmijë)

Eminja ka lindur në fshatin Hoxhaj [komuna e Tropojës] në Shqipëri. Pas martesës, ajo kaloi në Morinë/Morina. I kishte tre djem dhe një vajzë. Dy djem dhe vajza kanë ndërruar jetë herët. Ajo jetonte në bashkësi me djaln Zenunin dhe familjen e tij që i numëronte dhjetë anëtarë. Në muajin shkurt të vitit 1998, në fshat u themelua shtabi i UÇK-së, të cilit iu bashkëngjiten djelmoshat e Morinës/Morina dhe fshatrave përreth, në mesin e tyre edhe nipërit dhe kushërinjtë e Emines. Për shkak të përlëshjeve në mes të forcave të UÇK-së dhe atyre serbe në muajin qershor të vitit 1998, pjesëtarët e UÇK-së i kanë strehuar familjet e veta në Shqipëri. Eminja ka mbetur në fshat. Për të kujdeseshin nipërit dhe ushtarët e UÇK-së.

Në datën 7.07.1998, në mëngjes forcat serbe i sulmuan pozicionet e UÇK-së në **Morinë/Morina**. Pjesëtarët e UÇK-së e kanë strehuar plakën Emine në komandën e shtabit lokal, që gjendej në shtëpinë e familjes Demiri. I dhanë dy bomba. Forcat serbe kanë depërtuar në fshat rreth orës 14:00. Në luftimet me forcat serbe, në mesin e të cilëve gjendeshin dhe pjesëtarët e njësitit "Frenki", kanë rënë gjashtë pjesëtarë të UÇK-së [të shikohet regjistrimi]. Gjatë tërheqjes, pjesëtarë të UÇK-së kanë dëgjuar një shpërthim në shtabin e UÇK-së. Pas tërheqjes së tyre, forcat serbe u kanë vënë zjarr të gjitha shtëpive në fshat.

Pas përfundimit të luftës, në muajin tetor të vitit 1999, banorët e fshatit u kthyen dhe në gërmadhat e shtëpisë së familjes Demiri i kanë gjetur mbetjet mortore të Emines dhe dy bomba që i kishte me vete. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Eminen në varrezat e fshatit të Morinës/Morina.

Burimet: deklarata S.U, FDH-40551; J. Osmani, *Krimet...*, I, 305.